



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 31  
Prishtinë, më 02.10.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Glauk Konjufca, Elmi Reçica dhe Sërgjan Mitroviq.

**Pjesëmarrës nga MDIS:** Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike me bashkëpunëtorët: Lorik Pustina, Shyhrete Gosalci dhe Burim Krasniqi.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Egnesa Vitia, KK; Diellza Luzha, KDI; Marigonë Drevinja, PSD-Kuvend; Lira Haxhijakupi e Fjolla Vukshinaj, Germin dhe media.

**Nga zyra e komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 19, 25, 31 korrik dhe 20 shtator 2018;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investime Strategjike, z. Dardan Gashi, lidhur me Ligjin për Diasporë dhe çështje të tjera nga fushëveprimi i ministrisë;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 19, 25, 31 korrik dhe 20 shtator 2018**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 19, 25, 31 korrik dhe 20 shtator 2018*

### **3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investime Strategjike, z. Dardan Gashi, lidhur me Ligjin për Diasporë dhe çështje të tjera nga fushëveprimi i ministrisë**

**Dardan Gashi** sqaroi se në mbledhjen e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Kosovës është keqkuptuar kërkesa e ministrisë sa i përket kanalit të posaçëm për diasporën, sepse ideja është që në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, respektivisht në mes të dy televizioneve publike të krijohet një kanal i posaçëm i dy transmetuesve publikë për nevoja të diasporës. Në atë takim tha se është refuzuar ideja që të ketë një redaksi të posaçme jashtë Kosovës që do të krijojë kosto shtesë. Sa i përket Projektligjit të Diasporës tha se Qeveria e Kosovës dhe e Shqipërisë vitin e kaluar kanë nënshkruar një marrëveshje gjithëpërfshirëse sa i përket aktiviteteve të përbashkëta në diasporë dhe se një prej arsyeve të ndryshimit të ligji janë pikërisht këto aktivitete duke e përfshirë edhe idenë e televizionit. Qendrat Kulturore tha se kanë dështuar në mënyrën e funksionimit të tyre dhe se ato janë mbyllur. Ai më tej njoftoi se me ligjin e ri ato do të institucionalizohen dhe do të krijohen së bashku me Republikën e Shqipërisë. Sa i përket zyrtarëve që do të punojnë në këto qendra tha se është kërkuar që ata të jenë zyrtarë të Qeverisë me status diplomatik. Ai propozoi që të caktohen datat për organizimin e debateve të përbashkëta publike të cilat do të mbahen jashtë Kosovës dhe të vizitohet diaspora për të diskutuar për projektligjin. Po ashtu propozoi që gjatë këtyre takimeve të diskutohet edhe rreth përfshirjes së diasporës në jetën politike dhe në zgjedhjet e ardhshme, qoftë lokale apo qendrore.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, sa i përket kanalit televiziv të diasporës, shprehu mendimin se është e nevojshme të mbahet një takim i dy komisioneve, sepse kjo çështje nuk i përket vetëm mediave, por prek edhe funksionimin e diasporës. Ajo njoftoi se partia, të cilën ajo e përfaqëson e ka mbështetur krijimin e një kanali për diasporën dhe se duhet të gjendet mundësia më e mirë dhe më e lehtë, por edhe që nuk krijon shumë kosto financiare. Sa i përket statusit diplomatik të anëtarëve të qendrave kulturore pyeti se a janë duke u koordinuar me MPJ-në dhe se a është e përfshirë kjo çështje në ligjin e ri pasi që është duke u hartuar ligji i ri për shërbimin e jashtëm.

**Dardan Gashi**, sa i përket funksionimit të qendrave kulturore, njoftoi se ato kanë qenë në nivelin e OJQ-ve, por as si OJQ nuk kanë qenë të regjistruara në shtetet ku kanë operuar. Më tej njoftoi se me ligjin e ri, drejtuesi i Qendrës Kulturore do të jetë zyrtarë i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, por që ka lidhje në kuptimin diplomatik me Ministrinë e Punëve të Jashtme, rrjedhimisht me ambasadën e shtetit tonë. Me MPJ tha se është hartuar një memorandum bashkëpunimi, i cili do të nënshkruhet pas miratimit të ligjit. Ministri po ashtu njoftoi se janë dakorduar me Ministrinë e Financave që 5 pozita të jenë të përfshira në buxhetin e MDIS me status të përhershëm dhe se edhe Republika e Shqipërisë i propozon po ashtu 5 pozita në mënyrë që të fillohet vitin e ardhshëm me këtë projekt. Lidhur me konsultimet publike jashtë Kosovës tha se janë propozuar vetëm shtetet ku mendohet së është e rëndësishme të zhvillohen dhe se datat për organizimin e tyre janë alternative. Sa i përket shpenzimeve, MDIS ka paraparë që disa shpenzime të merren prej buxhetit të ministrisë. Ideja e këtyre konsultimeve publike tha se është që të mbahen dy debate, njëri për projektligjin dhe tjetri për pjesëmarrjen e diasporës në institucionet e vendit.

**Time Kadrijaj** tha se duke e ditur se ky projektligj do të kalojë përmes këtij komisionit, kjo është një alternativë e mirë që paraprakisht të kyçemi në këto debate publike, në mënyrë që kur procedohet projektligji në Kuvend ta kemi më të lehtë trajtimin e tij. Kadrijaj tha se meqenëse janë në procedurën e ndryshimit Ligji për Diasporën dhe Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik ne mund t'i trajtojmë të dy ligjet në mënyrë që të mos ketë dualizma në mes të dy ligjeve. Ajo shprehu mendimin se meqë është duke u hartuar strategjia për diasporën, komisioni mund të kontribuojë në hartimin e kësaj strategjie dhe se përfshirja e KQZ-së është një ide e mirë, pasi që ka pas defekte dhe është komplikuar mundësia e votimit nga jashtë vendit. Sa i përket kanalit televiziv, njoftoi se në takim me përfaqësues të diasporës shqetësimi i tyre ka qenë mungesa e një kanali televiziv dhe në atë takim është përkrahur ideja e krijimit të një kanali televiziv për diasporën.

**Fitore Pacolli**, lidhur me projektligjin, tha se është shumë i mangët, ka shumë hapësirë për t'u përmirësuar dhe se ka shumë pikëpyetje që ngritën në këtë projektligj. Duke iu referuar një draft dokumenti të publikuar në web-faqen e ministrisë, në të cilin thuhet "shto edhe Kartonin e Gjelbër si ide dhe bankën për diasporën", tha se kjo i bie që është pa planifikim ngase nuk ka planifikim të qartë se çfarë banke duhet të jetë për diasporën dhe se çfarë do të bëhet për Kartonin e Gjelbër. Sa i përket qendrave kulturore tha se dikush duhet të merr përgjegjësinë se pse janë themeluar këto qendra në atë formë dhe kanë dështuar dhe se duhet pasur kujdes se çfarë qendra do të krijohen në të ardhmen. Nëse këto qendra udhëhiqen nga pjesëtarët e MDIS ose të Qeverisë ekziston rreziku që këto qendra të keqpërdoren dhe të kontrollohet diaspora përmes menaxhimit të këtyre qendrave, tha Pacolli. Ajo propozoi që të merret si shembull "British Council" i cili operon i pavarur nga partitë politike. Pacolli shtoi se po krijohen hapësira për keqpërdorim të këtyre qendrave dhe se këto qendra duhet të jenë të pavarura nga Qeveria dhe partitë politike. Lidhur me këtë tha se është në rregull nëse qendrat mbikëqyren nga Qeveria, nëse është duke u aplikuar plani që synon Qeveria, mirëpo nëse Qeveria emëron njerëz të saj, atëherë këto qendra do të keqpërdoren nga partitë politike në pushtet.

**Dardan Gashi**, sa i përket projektligjit, tha se mund të ketë mangësi dhe se Kartoni i Gjelbër nuk ka qenë shprehimisht problem i ministrisë. Ai shtoi se MDIS e ka marrë çështjen e Kartoni të Gjelbër në mënyrë vullnetare, se i kanë krijuar disa lehtësira për bashkatdhetarët në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ministri më tej njoftoi se nuk kanë arritur ta zgjidhin problemin e Kartoni të Gjelbër dhe se futja e tij në ligj së bashku me Bankën për Diasporën është bërë me qëllim që të obligohet Qeveria që të merret me këto çështje. Sa i përket emërimeve në qendrat kulturore ministri tha se e kupton shqetësimin e deputetes Pacolli, duke shtuar se në të njëjtën mënyrë janë zgjedhur edhe ambasadorët dhe konsujt dhe se drejtuesi i një qendre nuk ka dallim të madh prej një ambasadori ose një konsulli. Ai më tej njoftoi se është përjashtuar mundësia që të shkojë dikush nga Kosova, për shkak se nuk do të ketë pagesë të banesës dhe pagesa të tjera. Drejtuesit e qendrës do të jenë njerëz të diasporës që janë atje që aplikojnë për të udhëheqë një qendër dhe të cilët nuk do të jenë diplomatë të karrierës.

**Evgjeni Thaçi-Dragusha**, në cilësinë e kryesueses së grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën, shprehu falënderimet për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e anëtarëve të ministrisë për t'u takuar dhe për t'u përgjigjur çështjeve të ngritura nga grupi punues. Sa i përket dëgjimeve publike shprehu mendimin se duhet të fokusohen më shumë në ligjin e ri dhe njoftoi se sa i përket monitorimit të ligjit aktual grupi punues është i gatshëm të paraqes raportin para komisionit pas përfundimit të disa procedurave. Lidhur me kanalën televiziv për diasporën tha se ka pasur vështirësi në implementimin e ligjit aktual lidhur me skemën programore 6-9% dhe se duhet të gjendet zgjidhja më e mirë për këtë çështje. Sa i përket mbylljes së qendrave kulturore pyeti se a është e mundur ligjërisht që ato të mbyllen, se a sjell kjo pasoja dhe se a do të rivitalizohen po të njëjtat qendra? Shprehu mendimin se ligji i ri do të bëhet për një periudhë afatgjate pavarësisht se kush është në qeveri dhe se duhet të gjendet zgjidhja më e mirë si për kryesuesit e qendrave kulturore, ashtu edhe për statusin e tyre. Ajo shtoi se tanimë ekziston edhe bashkërendimin me Republikën e Shqipërisë, që është një situatë e re dhe se ekspertet ligjor është mirë që t'i paraprijnë të gjitha problemeve që mund të paraqiten.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, lidhur me diskutimin e deputetes Evgjeni Thaçi, theksoi se më mirë do të ishte që raporti i grupit punues për mbikëqyrje të ligjit të miratohet në Kuvend, ku do të theksoheshin ngecjet të cilat do të merreshin parasysh në ligjin e ri.

**Zafir Berisha**, sa i përket qendrave kulturore në diasporë, tha se pozita e personelit në ato qendra duhet të rregullohet, të zgjedhën në bazë të meritave pa marrë parasysh se si do të quhen ata. Sa i përket kanalit televiziv për diasporën tha se Hungaria ka bërë një zgjidhje të mirë ku përmes TV shtetëror, ekziston një kanal i posaçëm për diasporën. Sa i përket çështjes së votimit dhe të

përfaqësimit të diasporës tha se janë çështje të cilat duhet të analizohen dhe të shqyrtohen në të ardhmen, dhe se duhet menduar si shoqëri në ndryshimin e vendeve të rezervuara.

**Fitore Pacolli**, duke u ndërlidhur me hartimin e Projektligjit për Diasporën, pyeti ministrin Gashi se kush është konsultuar gjatë hartimit të tij, cilat organizata të shoqërisë civile, çfarë është arritur në tri punëtoritë e mbajtura, kur është hapur për konsultim publik online projektligji, për të cilat informata tha se nëse nuk mund t'i kemi tani, mund të përcillen me shkrim nga ministria.

**Dardan Gashi** njoftoi se organizata Germin është konsultuar gjatë gjithë kohës sa i përket diasporës. Ai theksoi se asnjë debat nuk është mbajtur pa prezencën e ekspertëve dhe të shoqërisë civile. Ministria tha se angazhohet që për këtë projektligj të pajtohen të gjithë anëtarët e komisionit dhe të gjitha grupet e interesit në diasporë. Nëse është e nevojshme për komisionin tha se mund të përgatisim raport me shkrim lidhur me hartimin e projektligjit.

**Time Kadrijaj** theksoi se sa i përket projektligjit, komisioni atë duhet ta shqyrtojë, ta amendamentojë dhe ta përcjellë për miratim në seancë plenare. Znj. Kadrijaj tha se pas një deklaratë në media se opozita ka qenë kundër liberalizimit të vizave, apelon që të gjithë të angazhohen në procesin e liberalizimit të vizave sepse padrejtësisht qytetarët e Kosovës janë duke u mbajtur të izoluar në këtë proces.

**Vjosa Osmani-Sadriu** tha se sa i përket liberalizimit të vizave secili deputet i komisionit ka luajtur rol pozitiv dhe kudo ka lobuar pa marrë parasysh se a është pozitë apo opozitë. Shkelja e së drejtës së votës dhe përfaqësimit si dy të drejta elementare janë patjetër tema me të cilat duhet të merremi. Në këtë drejtim theksoi se do të ishte mirë që komisioni të mbajë një takim joformal me KQZ-në, për të diskutuar lidhur me këto brenga që i ka diaspora. Sa i përket dëgjimeve publike lidhur me projektligjin tha se do të mbahet një takim i përbashkët për të detajizuar vizitat, datat e tyre, vendet e delegacionet.

#### 4. Të ndryshme

a) Komisioni, duke u bazuar në vendimin e seancës plenare, të dt. 14 qershor 2018, për ndryshimin e strukturës së komisionit sipas të cilit deputetët Visar Ymeri dhe Aida Dërguti, zëvendësohen me deputetët Glauk Konjufca dhe Fitore Pacolli-Dalipi dhe me kërkesë të znj. Pacolli, vendosi që këto ndryshime të reflektojnë edhe në përbërjen e grupeve punuese. Sipas këtyre ndryshimeve tani anëtar i grupit punues për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare nga GP-VV është deputeti Glauk Konjufca.

Po ashtu sipas këtyre ndryshimeve grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, e kryeson deputetja Fitore Pacolli Dalipi, e cila është edhe anëtare e grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën dhe Ligjit për Investimet Strategjike.

b) Komisioni vendosi që për pagesat mbi 100 euro nga buxheti i komisionit, për financimin e aktiviteteve të komisionit të cilat kërkojnë vendimin e Komisionit, ta autorizojë kryetaren që brenda vitit buxhetor 2018, në rastet e nevojshme të bëjë pagesat duke u thirrur në vendim të kësaj mbledhje dhe të mos ketë nevojë për të ftuar mbledhje për këtë qëllim.

c) Kryetarja e Komisionit njoftoi se formimi i grupit punues i cili ka qenë i angazhuar për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare e ka objektin e trajtimit të ngjashëm me strategjinë e cila është hartuar për marrëdhënie ndërkombëtare nga Projekti i Binjakëzimit. Miratimi i kësaj strategjie tha se është paraparë në Planin e Zbatimit të MSA-së dhe duhet të përfundojë deri në fund të këtij viti. Për këtë qëllim tha se është e nevojshme që komisioni të punojë në përbërje të plotë për të shqyrtuar dy koncepte dokumente ekzistuese dhe ato më pas të procedohen për miratim. Në këtë drejtim kryetarja propozoi që të organizohet një punëtori dyditore, që të punohet ekskluzivisht për këtë çështje, për të cilën u pajtua komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Kryetarja e komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.